Përtej Dykuptimësisë Konstruktive

Si të ndalojmë së shqetësuari dhe ta duam Asociacionin/Bashkësinë e komunave me shumicë serbe

National Endowment for Democracy
Supporting freedom around the world

AKTIV

Contents

I Hyrje..... 2

II COVID-19..... 4

III Pse Prishtina duhet të ndalet së frikësuari nga A/BKShS.... 6

IV Pse një Asociacion/Bashkësi e komunave me shumicë serbe në Kosovë?..... 9

V Një zbatim i propozuar i kornizës..... 17

VI Përfundim..... 22

I Hyrje

Edhe pse e rënduar nga pandemia COVID-19, Kosova po përballet me një situatë ku procesi i dialogut kishte ngecur në masë të madhe dhe përpjekjet për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme dukshëm ishin shuar derisa Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian garuan për ndikim në Kosovë.[1] Për më tepër, brenda Kosovës, qeveria është munduar për të siguruar zgjidhje adekuate dhe të qëndrueshme institucionale ndaj diskriminimit, dhunës dhe ndarjes. Asnjë nga këto çështje nuk është adresuar në mënyrë adekuate, e as nuk janë propozuar mjete juridike të mundshme nga procesi aktual i dialogut. Për më tepër, ngritja e konceptit të 'ndarjes'[2] si një zgjidhje e propozuar nuk premton të adresojë shqetësimet institucionale dhe ligjore të serbëve në Kosovë, veçanërisht të atyre në jug të lumit Ibër. Pyetja që lind pa dyshim për shkak të kësaj është nëse institucionet e Kosovës janë, nga pikëpamja strukturore, në mundësi apo të gatshme për të adresuar problemet me të cilat përballen komunitetet jo-shumicë dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre ligjore dhe kushtetuese në një mënyrë sistematike?

Për t'u përgjigjur në këtë pyetje, ky propozim do të shikojë potencialin që ka një Asociacion/Bashkësi e komunave me shumicë serbe në Kosovë (A/BKShS) për të zgjidhur shumë probleme me të cilat ballafaqohen serbët e Kosovës. Argumenti kryesor i Asociacionit do të jetë se formimi i një organi të tillë mund të krijojë një kornizë institucionale për një zgjidhje të qëndrueshme afatgjate të çështjeve të lartpërmendura. Kjo, së bashku me pikat e tjera të shqyrtimit, do të shtjellohen më tej në pjesët në vijim.

Para se të thellohemi në më shumë detaje në lidhje me formimin e mundshëm të A/BKShS, duhet të theksohet se paraqet një numër sfidash ligjore për Kosovën. Disa aspekte të A/BKShS u konsideruan potencialisht jo kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës me vendimin e lëshuar me datë 23 dhjetor 2015.[3]

[1] https://balkaninsight.com/2020/06/17/us-and-eu-policy-on-kosovo-is-in-disarray/

[2] http://www.ngoaktiv.org/uploads/documents/scenario-territorial-exchange-between-serbia-and-kosovo-and-it-s-repercussions-for-serbs-south-of-the-ibar.pdf

[3] Aktgjykimi Nr. KO 130/15, Gjykata Kushtetuese e Kosovës. https://gjk-ks.org/en/decision/concerning-the-assessment-of-the-compatibility-of- the-principles-contained-in-the-document-entitled-associationcommunity-of-serb-majority- municipalities-in-kosovo-general-principlesmain/

Kjo e vuri në pikëpyetje natyrën eventuale dhe shtrirjen e fuqisë që A/BKShS do të kishte. Sidoqoftë, në mungesë të ndonjë marrëveshjeje ose ligji të qartë në lidhje me themelimin e A/BKShS të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, është e parakohshme të hyjmë në një diskutim të hollësishëm të ligjshmërisë së një entiteti akoma jo ekzistues. Përveç kësaj, fakti që qeveria e Kosovës është palë në Marrëveshjen e Brukselit[4] (2013) dhe Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e Përgjithshme/Elementet Kryesore (2015)[5], nënkupton që ligjërisht është e detyruar të krijojë A/BKShS dhe duke mos e bërë një gjë të tillë do ishte një heqje dorë e qartë nga zotimi që dha me nënshkrimin e atyre marrëveshjeve.

Duke marrë në konsideratë këto argumente, ky propozim nuk do të kërkojë të analizojë me hollësi imtësitë ligjore të A/BKShS por përkundrazi të paraqesë një sërë argumentesh në favor të krijimit të tij dhe pse është i nevojshëm në mënyrë që të ruhet dhe mbrohet plotësisht komuniteti serb i Kosovës dhe në të vërtetë të kontribuoj (pozitivisht) në stabilitetin lokal dhe rajonal si dhe në procesin e ndërtimit të paqes.

Ky punim është hartuar në besimin dhe supozimin se A/BKShS duhet të ketë një sërë kompetencash siç parashikohet nga nenet 4-6 të Marrëveshjes së Brukselit, të cilat theksojnë se Asociacioni/Bashkësia duhet të ketë 'pasqyrë të plotë' në fushat kryesore të jetës publike në komunitetet me shumicë serbe.[6] U konceptua dhe u hartua duke pasur parasysh një skenar të 'rastit më të mirë' në mënyrë që të demonstronte potencialin pozitiv që ka si për Kosovën ashtu edhe për rajonin në tërësi.

[4] Marrëveshja e Brukselit Nenet 1-6. https://www.srbija.gov.rs/cinjenice/en/120394

[5] http://eeas.europa.eu/archives/docs/statements-eeas/docs/150825_02_ association-community-of-serb-majority-municipalities-in-kosovo-general- principles-main-elements_en.pdf

[6] 4. Në përputhje me kompetencat e dhëna nga Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe ligji i Kosovës, komunat pjesëmarrëse do të kenë të drejtë që kolektivisht të bashkëpunojnë në ushtrimin e kompetencave të tyre përmes Asociacionit/Bashkësisë. Asociacioni/Bashkësia do të ketë një pasqyrë të plotë të fushave të zhvillimit ekonomik, arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural.
5. Asociacioni/Bashkësia do të ushtrojë kompetenca të tjera shtesë siç mund të delegohen nga autoritetet qendrore.
6. Asociacioni/Bashkësia për këtë qëllim do të ketë një rol përfaqësues ndaj autoriteteve qendrore dhe do të ketë një vend në këshillin konsultativ për komunitete. Për realizim të këtij roli parashikohet një funksion monitorimi.

II COVID-19

Pasi që pandemia COVID-19 përfshiu të gjithë globin, qeveritë e mbingarkuara nga shkalla e problemit, nxituan të miratonin masa të hartuara për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të tij. Pjesa më e madhe e botës e gjeti veten nën izolim të rreptë në rrethana që ishin të panjohura për shumicën. Në këto kushte të pazakonta dhe të frikshme, shtetet u përballën me një sërë sfidash unike: si të mbrojnë shëndetin dhe mirëqenien publike, ndërsa në të njëjtën kohë të garantojnë mbrojtjen e të drejtave themelore civile dhe njerëzore? Kosova, me strukturat e saj relativisht të dobëta institucionale dhe me themelet e lëkundura kushtetuese dhe ligjore, e gjeti veten në një pozitë veçanërisht sfiduese. Përgjigja e Qeverisë së Kosovës, në shumë aspekte, ishte kryesisht në përputhje me atë të qeverive të tjera në Evropë; izolime të rrepta, distancim shoqëror, kufizime në lëvizje dhe tubime, si dhe një varg veprimesh tjera me qëllim të zbutjes së ndikimeve të pandemisë. Siç u tha, situata emergjente hodhi një dritë të zymtë mbi problemet para-ekzistuese me të cilat përballen komunitetet jo-shumicë të Kosovës. Situata përkeqësoi më tej ndjenjat e izolimit dhe ostracizmit për shkak të komunikimit të pabarabartë dhe joefektiv me institucionet qendrore qeverisëse, incidenteve të dhunshme që synojnë individët dhe pronën private si dhe qasjes së diskutueshme të ndihmës financiare dhe materiale.

Pandemia nuk është burimi i vetëm i problemeve me të cilat ballafaqohet Kosova, por i bëri dëm përpjekjeve të dialogut dhe në të vërtetë shërbeu për të shkëputur vëmendjen nga çështjet e shumta me të cilat përballen komunitetet jo-shumicë të Kosovës. Për më tepër, ekspozoi shkallën në të cilën disa nga institucionet kosovare nuk janë të gatshme të reagojnë në mënyrë adekuate ndaj shkeljeve të të drejtave kushtetuese të grupeve të pakicave. Për më tepër, pasiviteti i vazhdueshëm nga ana e misioneve ndërkombëtare në Kosovë tregon se komuniteti serb ka nevojë për një kornizë institucionale, e cila mjaftueshëm do të adresonte boshllëqet aktuale në zbatimin e normave legjislative dhe kushtetuese që përndryshe ishin krijuar për të mbrojtur të drejtat themelore civile të komuniteteve jo-shumicë.

A/BKShS shpesh pikturohet në diskursin publik në një mënyrë çorientuese dhe ndoshta edhe të pandershme, duke çuar në keqkuptime të përhapura se cili është misioni i tij fillestar. Kjo ka çuar në një paqartësi të gjatë shtatëvjeçare, në të cilën formimi i A/BKShS kryesishtështë harruar si një përparësi politike si nga Prishtina, Beogradi ashtu edhe nga fasilitatorët kryesorë të procesit të dialogut si Brukseli dhe Uashingtoni.

III Pse Prishtina duhet të ndalet së frikësuari nga A/BKShS

Argumenti më evident kundër A/BKShS në diskursin publik është se Asociacioni do të përbënte një lloj 'Republika Srpska'[7] dhe si i tillë një kërcënim për integritetin territorial të Kosovës. Kjo mund të përshkruhet si 'gjuhë e koduar' pasi nënkupton shumë mundësinë që A/BKShS të ketë një ndikim tinëzar në jetën publike në Kosovë dhe që ai të jetë një faktor destabilizues. Spektri i irredentizmit dhe tregimet që e rrethojnë gjenerojnë një nivel frike që mund të përjashtojë të pasurit një pamje objektive të zgjidhjeve me potencial të konsiderueshëm për shkak të faktit se ato perceptohen se kanë objektiva 'të fshehura'. Ky është me të vërtetë rasti me A/BKShS - problemi nuk është domosdoshmërish nëse do të ketë apo jo kompetenca ekzekutive, por më tepër me peshën e tij negative simbolike në atë që besohet se A/BKShS është një mënyrë e tërthortë e minimit të integriteti territorial të Kosovës. Është sugjeruar, për shembull, që A/BKShS do veprojë si një mjet sekret për Qeverinë Ruse për të ushtruar ndikim mbi çështjet e Kosovës. Në fakt ka pak ose aspak prova që sugjerojnë se është kështu, duke pasur parasysh praninë e nivelit shumë të ulët rus në territorin e Kosovës dhe kontaktet e rralla midis zyrtarëve rusë dhe përfaqësuesve politikë serbë nga Kosova.

Në vend që të përqendrohemi në ndikimin (e perceptuar) rus, është ndoshta më e dobishme të kthehemi në argumentin se A/BKShS do të përbënte një entitet të ngjashëm me Republika Srpska në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ky argument është me mangësi të shumta për një numër arsyesh, duke filluar nga fakti që pasqyron një keqkuptim të thellë të a) asaj që do të jetë A/BKShS dhe b) çdo gjëje në lidhje me Bosnjën, politikën boshnjake ose Republika Srpskën. Vet fakti se askush nuk ka ofruar një shpjegim të hollësishëm ose të argumentuar të 'spektrit të Republika Srpskës' tregon mungesën e debatit të duhur në diskursin publik në lidhje me krijimin e A/BKShS. Bosnja dhe Hercegovina është një krijim i Marrëveshjeve të Dejtonit dhe ka ndoshta një nga sistemet politike më të ndërlikuara, të ngatërruara dhe kaotike në Evropë, nëse jo në botë. Edhe pse nuk është përcaktuar me kushtetutë si i tillë, ai në funksion është një shtet federativ (ose

[7] https://balkaninsight.com/2013/12/12/kosovo-ngo-predicts-a-republika-srpska-to-be-formed/

ndoshta konfederativ).[8] [9] Për më tepër, Republika Srpska si një organ nënshtetëror ka një autonomi të gjerë dhe kushtetutën e saj, ligjet, kuvendin dhe sistemin ligjor.[10] Krijimi i diçkaje të krahasueshme në Kosovë do të ishte e diskutueshme nga pikëpamja kushtetuese dhe e pamundur nga ana funksionale, duke pasur parasysh natyrën e kornizës së saj ligjore dhe shtrirjes gjeografike të komuniteteve serbe që janë shpërndarë në mënyrë të pabarabartë në të gjithë territorin. Krejt ndryshe nga Republika Srpska, A/BKShS nuk parashikohet të ketë gamën e kompetencave ligjore dhe ekzekutive që kanë njësitë federale. Për shembull, shtetet amerikane kanë ekzekutivin (guvernatorët), kuvende, kushtetuta, kode ligjore, forca policore dhe gëzojnë një autonomi që është shumë më e gjerë dhe më e thellë se ajo që do të kishte A/BKShS.

Është e vërtetë që A/BKShS do të zotëronte atë që mund të përshkruhet lirshëm si 'kompetenca të transferuara' në kuptimin që do të përfshinte transferimin e një sasie të caktuar të autoritetit ekzekutiv nga niveli qendror i qeverisjes tek Asociacioni. Kjo, sipas të gjitha gjasave, do të mbulonte çështjet lokale/të komunitetit, fusha të tilla si kujdesi shëndetësor, arsimi, kultura (trashëgimia kulturore), mirëqenia sociale dhe infrastruktura. Të përjashtuar nga kjo pothuajse me siguri do të ishin kompetencat gjyqësore, policia, politika e jashtme dhe e sigurisë.

Nëse një krahasim ndërkombëtar duhet të bëhet, ai mund të gjendet në Tirolin Jugor në Itali. Edhe pse dukshëm ndryshe në kuptimin që A/BKShS nuk do të përbënte një provincë apo ndarje tjetër të ngjashme territoriale, ai do të kishte një nivel të krahasueshëm të autonomisë. Tiroli Jugor ka kontroll të plotë mbi çështjet lokale, të pavarur nga ekzekutivi[11], që kujton 'pasqyrën e plotë' të përcaktuar në Marrëveshjen e Brukselit.[12] Tiroli Jugor përmendet shpesh si një histori suksesi, në kuptimin që iu siguruan mekanizma për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve etnike (zakonisht rreth gjuhës dhe kulturës) dhe ka krijuar një pozicion të qëndrueshëm për pakicën gjermano folëse të Italisë brenda sistemit ligjor dhe institucional të atij vendi[13].

[8] https://www.theguardian.com/news/datablog/2014/oct/08/bosnia-herzegovina-elections-the-worlds-most-complicated-system-of-government
[9] IBID
[10] Kushtetuta e Bosnjes dhe Herzegovinës, neni III, Ligji dhe Përgjegjësitë e Subjekteve dhe Institucioneve
[11] Neni 8, Statut i veçantë për Trentino Alto Adige
[12] Neni 4, Marrëveshja e Brukselit
[13] https://web.archive.org/web/20071008123321/http://www.civil.ge/eng/detail.php?id=15335

'Argumenti Srpska' është në fakt një formë e politikës së koduar 'dog-whistle politics'; përdorimi i gjuhës së koduar që mbështetet jo nga argumente racionale, por më tepër nga thirrjet emocionale të narracioneve nacionaliste që në realitet nuk kanë një bazë. Në përgjithësi, ky argument kundërshtohet lehtë për shkak të një numër arsyesh:

- Nuk do të përbënte një federalizim të Kosovës. Bosnja dhe Hercegovina është një shtet federal trepjesësh, i ndarë në dy njësi kryesore, njëra prej të cilave është Republika Srpska që gëzon një nivel të autonomisë të krahasueshme me atë të Skocisë në Mbretërinë e Bashkuar ose një subjekt federal në SHBA, Brazil, Kanada, ose Rusi. Ndryshe nga Republika Srpska ose Kebeku, ajo nuk do të drejtonte një politikë të jashtme pothuajse të pavarur me zyra përfaqësimi jashtë vendit.[14]
- Ndryshe nga njësitë federale në SHBA ose Kanada, Asocacioni nuk do të lëshonte dokumentet e veta të identifikimit;
- A/BKShS nuk do të kishte një kushtetutë ose një seri ligjesh të pavarura nga ato të Kosovës, por më tepër një statut që rregullon çështjet e brendshme, procedurat dhe funksionet;
- A/BKShS nuk do të kishte domosdoshmërish një ndikim në çështjet e sigurisë së brendshme.

[14] Sipas nenit 2A të Kushtetutës së Bosnjë dhe Hercegovinës, entitetet mund të krijojnë "marrëdhënie paralele" me shtetet fqinje. Republika Srpska ka zyra përfaqësuese në Izrael, Qipro dhe Rusi (http://www.vladars.net/sr-SP-Cyrl/Vlada/Predstavnistva/Pages/default.aspx)ndërsa, ndër të tjera Kebeku ka misione në Shtetet e Bashkuara, Mbretërinë e Bashkuar dhe Meksikë (http://www.mrif.gouv.qc.ca/en/ministere/representation-etranger)

IV Pse një Asociacion/Bashkësi e omunave me shumicë serbe në Kosovë?

Shtatë vjet nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Brukselit, përparimi drejt arritjes së një zgjidhje përfundimtare duket të jetë më i pakapshëm se kurrë. Mungesa e vullnetit politik midis palëve përkatëse të interesit dhe një situatë e paqëndrueshme politike në Ballkanin Perëndimor kanë krijuar një pengesë të madhe në përmbushjen e të drejtave themelore të komunitetit të serbëve të Kosovës. Janë shkruar dokumente të shumta, janë kryer studime dhe janë hartuar analiza në lidhje me gjendjen e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë. Më shumë mund të pritet. Për nga natyra e tyre, përfundimet janë të ngjashme: Kosova ka një themel të gjerë kushtetues dhe ligjor kur bëhet fjalë për mbrojtjen e kulturave, gjuhëve dhe pozicioneve politike të popujve të saj jo-shumicë, por kjo nuk është "zbatuar në praktikë". Pjesa e fundit e kësaj fjalie është thënë në konferenca, seminare dhe takime të panumërta dhe është shpërndarë në seksionet e 'përfundimeve' të botimeve dhe raporteve të shumta të nxjerra nga misionet ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile. Të gjithë janë përpjekur të adresojnë një çështje që ka qëndruar pezull në Kosovë gjatë dekadës së kaluar: si mund të krijohet një situatë ku institucionet qeverisëse do të ishin në gjendje të integrojnë me sukses serbët e Kosovës duke respektuar të drejtat e tyre ligjore dhe kushtetuese? Sidoqoftë, asgjë nga këto nuk ka çuar në ndërmarrjen e hapave konkretë/realë për ta arritur këtë. Një mjet i mundshëm, i cili diskutohet rrallë, është krijimi dhe themelimi i një Asociacioni/Bashkësie të komunave me shumicë serbe në Kosovë.

A/BKShS, si koncept, përgjithësisht shihet negativisht nga shumica e publikut të gjerë në Kosovë[15] dhe efektet e tij të mundshme pozitive në marrëdhëniet ndëretnike, pajtim dhe shëndet të përgjithshëm institucional dhe politik të Kosovës janë injoruar në masë të madhe. Retorika e shumë akterëve politikë në Kosovë është ushqyer me parakonceptime negative se A/BKShS do të përbënte një kërcënim për shumicën shqiptare. Për më tepër, është një fakt që protestat e mëdha dhe shpesh të dhunshme reflektojnë kundërshtimin e ngulitur të idesë.[16] Kjo në masë të madhe për shkak të keqkuptimeve

[15] Opinioni Publik në Kosovë mbi Dialogun me Serbinë, Instituti Demokratik Kombëtar (NDI), 2018, fq. 5.

[16] https://balkaninsight.com/2015/10/13/albin-kurti-released-by-police-after -heavy-attacks-10-13-2015/

populllore të asaj që A/BKShS do të ishte në të vërtetë, çfarë fuqish do të kishte dhe rolit që do të luante në jetën politike dhe në procesin e ndërtimit të shtetit në Kosovë. Në këtë pjesë do të përshkruhen dhe elaborohen një numër argumentesh kryesore për A/BKShS.

1. Një Kornizë e qëndrueshme institucionale për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komunitetit

Tani është e nevojshme t'i kthehemi pyetjes që fillimisht u shtrua në pjesën hyrëse të këtij punimi: A janë institucionet të gatshme dhe të afta për të siguruar mbrojtje adekuate për komunitetin serb të Kosovës? Dy muajt e fundit duket se na kanë dhënë një përgjigje shumë të qartë: **Jo**.

COVID-19 ka ekspozuar mangësitë në komunikimin institucional midis pakicës serbe dhe shumicës shqiptare. Në thelb, ai ishte një mikrokozmos (ose ndoshta makrokozmos) i mangësive tashmë ekzistuese kur bëhet fjalë për zbatimin dhe respektimin e të drejtave të komunitetit në Kosovë. Nga marsi deri në qershor të vitit 2020, OJQ Aktiv monitoroi me kujdes ngjarjet e incidenteve potencialisht etnikisht të motivuara. U regjistruan gjithsej tridhjetë (30) zjarrvënie, vjedhje, sulme fizike dhe vandalizëm që shënjestruan anëtarët e komunitetit serb të Kosovës.[17] Duhet të theksohet se shumica dërrmuese e këtyre incidenteve nuk janë ndjekur penalisht si dhe nuk ka pasur arrestime të konsiderueshme. Për më tepër, mediat në gjuhën shqipe kryesisht i injoruan këto ngjarje, përveç një raporti në Koha Ditore rreth një sulmi fizik të kryer kundër një banori serb në Komunën e Istogut.[18] Gjithashtu e dukshme ishte mungesa e përkthimeve të udhëzimeve dhe urdhrave të qeverisë gjatë pandemisë, të cilat shërbyen për të gjeneruar një konfuzion dhe shqetësim të gjerë. Kjo i thelloi edhe më tej ndjenjat e mos-besimit që serbët e Kosovës kanë ndaj qeverisë së Kosovës.[19]

[17] Bazuar në raportet nga anëtarët e Grupit Qytetar për Reagim të Shpejtë (RRCG) nga marsi deri në qershor të vitit 2020.

[18] https://www.koha.net/kosove/225596/ne-oprashke-te-istogut-rra-het-nje-serb-mkk-thote-se-nga-shkurti-ky-eshte-incidenti-i-26-te/

[19] Sipas Anketës së Analizës së Trendit të vitit 2019 të realizuar në kominitetin serb të Kosovës nga OJQ Aktiv, Serbët në Kosovë shprehën besimin dhe sigurinë më të vogël në Qeverinë e Kosovës nga të gjitha institucionet dhe organet e tjera (si ato rajonale ashtu

Këto probleme, pavarësisht nga shkaku i tyre, rritën ndjeshëm ndjenjën e tjetërsimit të serbëve të Kosovës. Komunikimi dhe koordinimi i dobët midis Prishtinës dhe Beogradit gjithashtu kontribuoi në një mungesë të përgjithshme qartësie dhe konfuzioni gjatë pandemisë COVID-19. Prandaj do të duket se "dykuptimësia konstruktive" nuk është vetëm një koncept i pranishëm në letër, por diçka që praktikohet në mënyrë aktive nga qeveritë si në Prishtinë ashtu edhe në Beograd.

Një A/BKShS do të shërbente për të ofruar një numër zgjidhjesh të qarta, praktike dhe të qëndrueshme për shumë prej çështjeve të përshkruara më sipër dhe do ta bënte atë si në vijim:

- Siç do të elaborohet më tej, A/BKShS ka potencialin të centralizojë një gamë të gjerë shqetësimesh dhe interesash duke krijuar një mjet sistematik për adresimin e tyre;
- Mund të ofrojë instrumente për lehtësimin e **zgjidhjeve lokale për problemet lokale** që komuniteti serb i Kosovës të adresojë çështjet që drejtpërdrejt prekin komunitetet e tyre (p.sh. ndotja e Lumit të Graçanicës, ndërtimi i hidrocentraleve të vogla në Shtërpcë dhe probleme të tjera të ngjashme).
- Mund **lehtësojnë komunikimin midis institucioneve qeverisëse të nivelit qendror i cili më parë ose ka munguar ose ka qenë i pjesshëm**;
- Mund të lehtësojë dhe modernizojë **komunikimin në mes të Beogradit dhe Prishtinës duke ofruar një kanal të qëndrueshëm për shkëmbim të informacionit dhe bashkëpunimin**;
- Mund të zvogëlojë ndjeshëm presionin dhe stresin mbi institucionet e tjera të Kosovës nga **krijimi i një bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve të qeverisjes lokale dhe qendrore politike - me fjalë të tjera, do të ishte një organ me kompetenca të mjaftueshme për të mbrojtur në mënyrë efektive shumë të drejta të komunitetit si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror**;

- Mund të veprojë si një trup që është i aftë të **artikulojë nevojat e komunitetit serb të Kosovës,** në kuptim që do të institucionalizonte marrëdhëniet midis një komuniteti jo-shumicë dhe shumicës;

- Mund të kontribuojë shumë në integrimin e serbëve të Kosovës duke u ofruar atyre mbrojtje adekuate institucionale dhe një shtresë qeverisjeje që do të rrisë nivelin e besimit dhe do të ulë ndjenjat e tjetërsimit;

- Mund të ketë një shkallë të autonomisë që do ta lejojë atë të ushtrojë 'përmbledhje' dhe kontroll mbi fusha të tilla si arsimi, kujdesi shëndetësor, mirëqenia sociale dhe trashëgimia kulturore duke hequr polemikat mbi të ashtuquajturat 'institucione paralele'.' **Do ta bënte këtë duke zyrtarizuar dhe legalizuar mbështetjen e ofruar për komunitetet serbe në Kosovë nga Republika e Serbisë**;

- Mund të ketë një ndikim dukshëm pozitiv në shëndetin dhe sigurinë e të gjitha komuniteteve duke krijuar kanale të reja të kontaktit zyrtar dhe komunikimit midis ofruesve të shërbime shëndetësore dhe të mirëqenies;

- Mund të krijojë më shumë cilësi dhe barazi brenda komunitetit serb të Kosovës duke zvogëluar mospërputhjet midis shumës së financimit dhe vëmendjes së marrë nga katër komunat veriore në krahasim me ato në jug të lumit Ibër, që do të kontribuonte më tej në konceptin e decentralizimit në Kosovë duke transferuar më shumë përgjegjësi në nivelin e qeverisjes lokale;

2. A/BKShS si një garantues i mundshëm i stabilitetit

Më shumë se njëzet vjet pas përfundimit të armiqësisë, Kosova është ende e rrethuar nga shpërthime sporadike të dhunës dhe paqëndrueshmërisë. Prezantimi i idesë së ndarjes ose 'shkëmbimit territorial' në diskursin publik ka futur një shkallë shtesë të pasigurisë dhe paqartësisë në procesin e dialogut dhe ka sjellë në pikëpyetje të ardhmen e komunitetit serb të Kosovës: nëse një plan i tillë realizohet, do të kërcënonte të drejtat themelore ligjore dhe kushtetuese të serbëve në Kosovë, për më tepër kushtetutshmëria

e konceptit si në Serbi ashtu edhe në Kosovë është shumë e diskutueshme.[20] Për më tepër, ideja perceptohet negativisht nga një shumicë e madhe e shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve, të dyja të prira ta shohin atë si një skenar potencialisht destabilizues, megjithëse për arsye të ndryshme[21]. Për më tepër, një plan i tillë do të krijonte një ndarje fizike të serbëve të Kosovës, duke i lënë ata që jetojnë në jug të Ibrit në një pozitë të pasigurt dhe me më pak të drejta politike dhe civile sesa kanë tani dhe do të çonte në izolimin e tyre të mëtejshëm (duke përfunduar me asimilim?).[22] Komplikimi i çështjes dhe një shkak i shumë bashkërendimeve midis shqiptarëve është politika e Serbisë për të bllokuar anëtarësimin e Kosovës në organe dhe organizata ndërkombëtare dhe rajonale, që do të thotë se negociatat shpesh sillen në rreth dhe rezultojnë në rrugë pa dalje. Nga ana tjetër, mungesa e vullnetit nga ana e elitave politike në Prishtinë për të zbatuar plotësisht Marrëveshjen e Brukselit (siç është A/BKShS) ka prodhuar akoma më shumë bllokime rrugësh në procesin e normalizimit të marrëdhënieve. Përzierja e këtyre problemeve është fakti që komuniteti serb i Kosovës ka gjetur vetën të ngrirë në procesin e dialogut, nevojat e tyre anashkalohen ose injorohen nga akterët politikë si në Prishtinë ashtu edhe në Beograd.

Një faktor i harruar shpesh është ai i prosperitetit dhe stabilitetit ekonomik, që tenton të humbasë në diskutimet politike. Siç është rasti në të gjithë Ballkanin, situata ekonomike në komunitetet serbe të Kosovës është e dobët. Në të vërtetë, faktorët ekonomikë janë një shkak kryesor i trendit gjithnjë në rritje të migrimit të jashtëm në mesin e popullatës serbe të Kosovës.[23]

Pyetja që buron nga e gjithë kjo është mjaft e thjeshtë: si është e mundur të dilet nga ky moçal dhe të gjindet një zgjidhje që jo vetëm adreson nevojat e komunitetit por që gjithashtu mund të apelojë dhe të ketë vlerë si për Prishtinën ashtu edhe për Beogradin? Si të arrihet një marrëveshje që mund të sigurojë stabilitet, siguri dhe mirëqenie për të gjitha palët e përfshira? Përderisa do të ishte naive të sugjerohet që A/BKShS është një zgjidhje shëruese pa pengesat e veta, ai ofron një mjettë caktuar për këto sëmundje, veçanërisht nëse adreson çështjet në një mënyrë holistike:

[20] http://www.ngoaktiv.org/uploads/documents/scenario-territorial-exchange-between-serbia-and-kosovo-and-it-s-repercussions-for-serbs-south-of-the-ibar.pdf
[21] Opinioni Publik në Kosovë mbi Dialogun me Serbinë, Instituti Demokratik Kombëtar (NDI), 2018, fq. 5.
[22] http://www.ngoaktiv.org/uploads/documents/scenario-territorial-exchange-between-serbia-and-kosovo-and-it-s-repercussions-for-serbs-south-of-the-ibar.pdf
[23] http://www.ngoaktiv.org/publication/trend-analysis-2019

- A/BKShS **mund të jetë një alternativë realiste, e arritshme dhe humane ndaj shkëmbimit / ndarjes territoriale** sepse bashkon komunitetin serb të Kosovës nën një ombrellë, ndërsa nuk paraqet kërcënim për integritetin territorial ose rendin kushtetues të Kosovës ose Serbisë;

- A/BKShS mund të jetë një **shembull i ofrimit të zgjidhjeve reale për mosmarrëveshjet etnike** duke shmangur grackat më të dukshme të ndarjes siç është paqëndrueshmëria rajonale;

- Nëse Kosova **dëshiron të mbetet multi-etnike, atëherë duhet të përmirësojë dhe zgjerojë mekanizmat për mbajtjen e anëtarëve të të gjitha komuniteteve të saj** hapi i parë i të cilit do të ishte krijimi i A/BKShS;

- A/BKShS mund të jetë një lehtësues në procesin e ndërtimit të paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke u bërë potencialisht një histori suksesi për rajonin e Ballkanit Perëndimor (duke pasur parasysh marrëdhëniet e paqëndrueshme ndëretnike);

- Mund të krijojë një kanal shtesë të komunikimit ndërmjet serbëve të Kosovës, Prishtinës dhe Beogradit, i cili është i aftë t'u japë një zë serbëve të Kosovës në procesin e dialogut duke i dhënë kornizës së përgjithshme për bisedime një dimension shumë më të gjerë;

- Ka potencial për të gjeneruar mundësi ekonomike shtesë që do të motivonin serbët e Kosovës të qëndrojnë aty;

- Mund të përqendrojë fonde për zhvillim dhe infrastrukturë nën një ombrellë të vetme që mund të çojë në shpërndarje më të barabartë dhe të drejtë të ndihmës ekonomike dhe formave të tjera të ndihmës materiale, veçanërisht për ato komunitete që ende nuk kanë pasur qasje në burime të tilla siç është rasti me Fondin e zhvillimit për veriun e Kosovës;

- Mund të sigurojë një proces më të qëndrueshëm dhe më të sigurt të kthimit dhe riintegrimit duke e bërë A/BKShS arbitrin dhe lehtësuesin kryesor në atë proces në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.

3. A/BKShS dhe bashkësia ndërkombëtare

ASi faktor dhe lojtar kryesor në punët e brendshme dhe të jashtme të Kosovës, bashkësia ndërkombëtare është në gjendje të luajë një rol jetik në formimin e një A/BKShS të ardhshëm. Misionet ndërkombëtare dhe ambasadat e huaja ushtrojnë një shkallë të madhe të ndikimit kur bëhet fjalë për zhvillimet politike në Kosovë dhe shpesh kanë drejtuar rrjedhën e politikave të saj të brendshme. Komuniteti ndërkombëtar, përkundër përpjekjeve të tij për të inkurajuar të dy palët për të nënshkruar Marrëveshjen e Brukselit, është mjaft pasiv në ushtrimin e presionit për të zbatuar plotësisht stipulimet e saj. Për këtë pasivitet pjesërisht duhet fajësuar faktin se Kosova ende nuk ka krijuar A/BKShS, gjë që përndryshe ligjërisht është e detyruar ta bëjë.

Duke marrë parasysh këtë, A/BKShS paraqet vetveten si një mundësi unike për bashkësinë ndërkombëtare për të materializuar shumë nga qëllimet dhe vizionet e tyre fillestare për një shtet funksional, multietnik që është strukturor dhe sistematikisht i gatshëm për integrimin në BE. Formimi i A/BKShS nuk është një rrugë me një drejtim; është një mundësi e cila është reciprokisht e dobishme si për vetë Kosovën ashtu edhe për akterët ndërkombëtarë të pranishëm në rajon.

Krijimi i A/BKShS do të kërkonte vërtet përkushtim dhe punë të konsiderueshme nga ana e komunitetit ndërkombëtar, veçanërisht nga BE-ja, Shtetet e Bashkuara dhe ndoshta Kombet e Bashkuara dhe/ose Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Kjo, megjithatë, për arsye që do të përshkruhen më poshtë, premton një numër përfitimesh të mundshme:

- Pasi që Kosova aspiron të anëtarësohet në Bashkimin Evropian, formimi i A/BKShS do të nxisë respektimin e kërkesave strukturore të BE-së për anëtarësim dhe të sigurojë që BE përfundimisht të absorbojë një rajon më të qëndrueshëm;

- Si administratorët kryesorë të sigurisë rajonale në Ballkanin Perëndimor, natyra potencialisht stabilizuese e A/BKShS mund të shërbejë për të zvogëluar barrën financiare dhe strukturore për SHBA dhe BE;

- Formimi i A/BKShS mund të jetë një kornizë pozitive, e drejtuar nga zgjidhjet për adresimin e konflikteve etnike afatgjata, potencialisht të zbatuara në zona të tjera të Ballkanit dhe madje edhe më larg;

- Duke pasur parasysh mosmarrëveshjet aktuale midis SHBA-së dhe BE-së ndaj Kosovës, A/BKShS mund të veprojë si një faktor unifikues dhe një mundësi për bashkëpunim më harmonik drejt arritjes së qëllimeve të përbashkëta;

- Do të përmbushte premtimet/detyrimet përderisa në të njëjtën kohë do ta vinte Kosovën në rrugën e integrimit rajonal siç përcaktohet në Marrëveshjen e Brukselit.

V Një zbatim i propozuar i kornizës

Kjo kornizë e propozuar do të përbëhet nga dy udhëzues praktikë për sa i përket themelimit të A/BKShS. Duhet të kuptohet që ky është një grup idesh dhe konceptesh të sugjeruara dhe se krijimi i A/BKShS do të përfshijë një shkallë të caktuar të mosmarrëveshjeve ligjore, e cila nuk do të mbulohet plotësisht nga këto rekomandime. Për më tepër, nevoja për Gjykatën Kushtetuese për të siguruar që çdo A/BKShS eventual është në përputhje me normat kushtetuese duhet të merret në konsideratë.

Pas hartimit të statutit të A/BKShS, hapat e përshkruar më poshtë duhet të ndodhin brenda një periudhe jo më të gjatë se **dymbëdhjetë (12) muaj.**

1. Korniza procedurale për krijimin e A/BKShS

- Krijimi i një Komisioni për formimin e A/BKShS i cili do të përbëhej nga përfaqësues të komunitetit (politik), organizata të shoqërisë civile, si dhe përfaqësues të autoriteteve në Beograd. Komisioni do të lëshojë rekomandime fillestare për sa i përket përbërjes dhe kompetencave të A/BKShS (siç përcaktohet nga marrëveshjet dhe monitorohet nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës.);
- Fillimi i një fushate gjithëpërfshirëse të informimit publik që synon si komunitetin serb ashtu edhe shumicën shqiptare në mënyrë që të sqarojë keqkuptimet dhe të informojë qytetarët për përfitimet e A/BKShS dhe ndryshimet e tjera të ardhshme. Kjo duhet të përfshijë media tradicionale dhe sociale, si dhe ngjarje publike në stilin e kuvendit komunal. Kjo duhet të drejtohet nga institucionet publike në bashkëpunim me organizatat joqeveritare;
- Një thirrje për formimin e mundshëm të një komune të re Plemetin-Prilluzhë që do të bashkonte komunitetet serbe që jetojnë në dhe rreth komunave të Vushtrrisë dhe Obiliqit. Komuna e sapoformuar do të përfshinte fshatrat Babimoc, Gracë, Caravodicë. Kjo do të siguronte që numri i lartë i

serbëve që jetojnë në atë zonë do të ishin në gjendje të përfitojnë nga formimi i A/BKShS në përputhje të plotë me ligjet e Kosovës.[24] Serbët në këtë zonë nuk kanë komunën e tyre dhe për këtë arsye interesat e tyre përgjithësisht nuk përfaqësohen në nivel institucional, krijimi i një komune të tillë do të siguronte këtë lloj përfaqësimi. Bazuar në analizat faktike dhe ligjore të kryera nga Komisioni mbi mundësinë e krijimit të një komune të re, një propozim gjithëpërfshirës duhet të hartohet dhe t'i dërgohet Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe Kuvendit për debat dhe shqyrtim. Nëse rezultati i kësaj iniciative dëshmon se është në favor të krijimit të një komune të re me shumicë serbe, ajo do të dërgohet në Grupin Punues (përshkruar më poshtë) për absorbim në Statutin e A/BKShS;

- Një takim i fasilituar duhet të zhvillohet duke përfshirë përfaqësuesit politikë të serbëve të Kosovës, si dhe përfaqësues të autoriteteve komunale (nga radhët e anëtarëve të kuvendeve komunale nga dhjetë komuna me shumicë serbe) dhe anëtarët e Komisionit për formimin e A/BKShS. Duhet të marrin pjesë OSBE-ja, BE-ja, 'kuintet'[25], Qeveria e Kosovës, me një rol të veçantë këshillues nga ekspertët e Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim. Rezultati i këtij takimi do të ishte krijimi i një Grupi Punues (GP) për hartimin e një Statuti për A/BKShS, të përbërë nga anëtarët e organeve të lartpërmendura. Kjo duhet të ndodhë gjatë tre muajve, dhe pastaj institucionet do të kenë një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajsh për të ndërmarrë hapa të tjerë që çojnë në krijimin e A/BKShS;

- Në përputhje me nenin 6 të këtij ligji të Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbenë Kosovë - parimet e përgjithshme/elementet kryesore, duhet të themelohet një Kuvend i përbërë nga përfaqësuesit e emëruar nga kuvendet e komunave pjesëmarrëse;[26]

[24] Neni 12 i Ligjit për Kufijtë Administrativë të Komunave thotë se: "Qeveria do të hyjë në konsultime me komunitetet joshumicë, në rastet kur ky komunitet përbën së paku 75% të popullsisë në një vendbanim të përqëndruar në zona kadastrale të bashkëlidhura me popullsi të gjithëmbarshme prej së paku 5000 qytetarësh, me qëllim të krijimit të komunave të reja."

[25] Ambasadat e Shteteve të Bashkuara, Mbretërisë së Bashkuar, Italisë, Francës dhe Gjermanisë

[26] Neni 6, Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - parimet e përgjithshme/elementet kryesore "Asociacioni/Bashkësia do të ketë: Kuvendin, si trup më të lartë, të cilin e përbëjnë përfaqësuesit e emëruar nga kuvendet e komunave pjesëmarrëse, nga anëtarët e tyre të zgjedhur

- Statuti që do të hartohet nga Grupi Punues duhet të dërgohet në një 'kuvend konstituiv të përbërë nga anëtarët e votuar të kuvendeve të komunave pjesëmarrëse' për miratim.[27] [28] Pas kësaj, organet e tjera siç përcaktohet nga Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - parimet e përgjithshme/elementet kryesore duhet të formohen. Ky proces duhet të monitorohet nga BE-ja në bashkëpunim me institucionet e Kosovës;
- Pasi që këto procedura të jenë në përputhje me Brukselin dhe marrëveshjet e tjera dhe ligjin e Kosovës, A/BKShS duhet të fillojë të ushtrojë autoritetin dhe funksionet e tij sa më shpejt të jetë e mundur ligjërisht, nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të BE-së si lehtësues kryesor i procesit të dialogut.

2. Të menduarit jashtë kornizës: Propozime të vlerës së shtuar

- Sipas nenit 7 të Asociacionit/Bashkësisë se komunave me shumicë serbe në Kosovë - parimet e përgjithshme/elementet kryesore "Selia e Bashkësisë/Asociacionitdo të përcaktohet me Statut." Sugjerohet që të konsiderohet Graçanica si selia e A/BKShS për disa arsye:

> Graçanicë është selia jozyrtare e komunitetit serb të Kosovës në jug të Ibrit. Pavarësisht nga madhësia e saj relativisht e vogël, ajo megjithatë është një qendër kulturore, ekonomike dhe politike për atë rajon.

> Krijimi i një qendre administrative në Graçanicë do të kontribuonte në urbanizimin më të madh në një zonë (me shumicë serbe të Kosovës) që aktualisht nuk ka qendra më të mëdha urbane;

[27] Neni 3, Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - parimet e përgjithshme/elementet kryesore

[28] Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - parimet e përgjithshme/elementet kryesore nuk përcakton se kush do të jetë i ngarkuar/përgjegjës për hartimin e statutit.

Afërsia me Prishtinën si një qendër politike/administrative/ekonomike do të kontribuonte në një rritje të intensitetit dhe cilësisë së komunikimit ndërmjet organeve të A/BKShS dhe institucioneve të nivelit qendror. Për më tepër, Graçanica është e shtrirë në rrugët kryesore të transportit me lidhje të lehta me Prizrenin, Shkupin, Vranjën, Nishin dhe qendrat e tjera të mëdha të popullatës Serbe të Kosovës;

Do të nxisë zhvillimin e ri ekonomik dhe kulturor atje ku është shumë e nevojshme. Në këtë kuptim, do të ofronte perspektiva dhe motivime të reja për banorët vendas për të qëndruar;

Përkundër faktit se popullata e kombinuar serbe në jug të Ibrit është më e lartë se ajo e katër komunave veriore, Mitrovica e Veriut megjithatë vepron si një qendër e madhe administrative për serbët e Kosovës që ushtron një ndikim të madh politik, social dhe financiar. Selia e A/BKShS në Graçanicë do të zhvendoste qendrën e pushtetit politik në një zonë që ndryshe nuk përfaqësohet shumë.

- Në mënyrë që të sigurohet që të gjithë serbët e Kosovës të mund të gëzojnë përfitimet dhe mbrojtjet e ofruara nga A/BKShS, statuti i tij duhet të parashikojë hapjen e 'Zyrave Ndërlidhëse të A/BKShS' që do të vendosen në zonat e banuara nga një numër i konsiderueshëm i serbëve që janë jashtë kufijve të komunave me shumicë serbe:

Bajë (komuna e Skenderaj);
Gorazhdec (komuna e Pejës);
Kamenicë
Lipljan;
Osojan (komuna e Istogut);
Plemtin (komuna e Obiliqit);
Prelluzhë[29] (komuna e Vushtrrisë);
Shillovë (komuna e Gjilanit);
Hoçë e Madhe (komuna e Rahovecit);

[29] Vetëm në qoftë se nuk krijohet një komunë e re (siç është elaboruar më lart.)

- Zyrat ndërlidhëse të lartpërmendura do të shërbejnë për një qëllim të dyfishtë ngase do të lehtësonin komunikimin midis serbëve lokalë dhe autoritetet e tyre përkatëse komunale dhe si qendra për koordinimin administrativ me A/BKShS. Ato do të luanin një rol kur bëhet fjalë për monitorimin e aspekteve sociale, kulturore, ekonomike dhe të sigurisë së jetës lokale;

- Brenda organeve përfaqësuese të A/BKShS (kuvendit, këshillit, bordit dhe administratës), duhet të ketë pozita të caktuara për individët që janë, brenda fushës së A/BKShS, anëtarë të komuniteteve jo-shumicë (p.sh. shqiptarë, boshnjakë, RAE , malazezë, goranë). Kjo do të siguronte përfaqësimin e garantuar të interesave të të gjitha komuniteteve në A/BKShS dhe do pasqyronte natyrën e tij multi-etnike;

- Një zyrë e veçantë duhet të formohet brenda A/BKShS që do të mbikëqyrë ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe të Kosovës (të prekshme dhe paprekshme) në përputhje me nenin 4 të Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.[30] Kjo zyrë do të vepronte gjithashtu si ndërmjetës midis Beogradit dhe Prishtinës në lidhje me këto çështje;

- Për shkak të mungesës thelbësore të zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve[31], krijimi i një Departamenti për Përkthime do të siguronte përkthime të shpejta, në kohë dhe të duhura të udhëzimeve zyrtare të qeverisë, urdhrave, ligjeve dhe dokumenteve të tjerë të rëndësishëm me rëndësi publike. Në mungesë të një kursi zyrtar të arsimit të lartë për përkthim, departamenti do të shërbente si një qendër rekrutimi dhe arsimimi për përkthyesit/interpretët

- BE-ja si lehtësuesi kryesor i procesit të dialogut/normalizimit, duhet të ndërmarrë rolin e rojës kryesore gjatë gjithë procesit të propozuar/përshkruar në këtë dokument

[30] Neni 4 'Këshilli Zbatues dhe Monitorues', Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura
[31] http://ngoaktiv.org/publication/general-overview-of-language-rights-in-kosovo

VI Përfundim

Siç është përshkruar në detaje gjatë gjithë këtij punimi, A/BKShS është një mundësi unike për të siguruar një zgjidhje të prekshme për shumë prej sfidave aktuale të Kosovës dhe për të kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në procesin e normalizimit midis Beogradit dhe Prishtinës. Sidoqoftë, një veprim i tillë do kërkojë një qasje domethënëse dhe proaktive nga ana e të gjithë akterëve relevantë, si dhe një gatishmëri të re për bashkëpunim ndëretnik. Gjithashtu do të kërkojë një angazhim nga ana e elitave politike shqiptaro-kosovare për të punuar në mënyrë aktive për të zvogëluar ankthin midis përbërësve të tyre dhe për të qetësuar frikën që A/BKShS do të përbënte një kërcënim për stabilitetin dhe integritetin territorial të Kosovës. Paqëndrueshmëria aktuale politike në Kosovë si dhe ngërçi në negociata midis Beogradit dhe Prishtinës vetëm thellon dhe përkeqëson mosfunksionimin e përgjithshëm institucional në Kosovë. Duke përshtatur një kornizë ligjore që shenjtëron të drejtat e komuniteteve jo-shumicë, Kosova bëri një premtim që deri më tani nuk ka arritur ta mbajë, dhe A/BKShS mund ta korrigjojë këtë

Status kuoja nuk është më një opsion i zbatueshëm: A/BKShS mund të jetë një hap i parë i rëndësishëm drejt finalizimit të proceseve të ndërtimit të paqes, bashkëjetesës ndëretnike dhe demokratizimit

OJQ Aktiv
Igor Marković, MA
Caleb Waugh, MA